

VENDIM
Nr.621, datë 24.9.2007

**PËR FINANCIMIN E FILLIMIT TË PUNIMEVE NË SEGMENTIN RRUGOR LEVAN-
VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve), që, me fondet e TVSH-së, të programuara në buxhetin e vitit 2007, për projektin e rrugës Levan-Vlorë, të paguajë kontraktorin, me vlerën e paradhënies, në përputhje me kontratën e lidhur sipas standardeve të BERZH-it dhe BEI-it.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha